



ALBSIG JETË sh.a.

Pasqyrat financiare më 31 dhjetor dhe për periudhën 13 shtator 2019 deri më 31 dhjetor 2019
Së bashku me Raportin e Audituesit të pavarur



MAZARS

Përmbajtja

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR	1
Pasqyra e Pozicionit Financiar	3
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave gjithpërfshirëse	4
Pasqyra e ndryshimeve në kapital	5
Pasqyra e fluksit të parasë	6
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE	7
SKEDULE SUPLEMENTARE	30

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Menaxhimin dhe aksionarët e Shoqërisë Albsig Jetë sh.a

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë **Albsig Jetë sh.a** (Shoqëria) të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2019, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për periudhën 13 shtator 2019 deri më 31 dhjetor 2019, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2019, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për periudhën 13 shtator 2019 deri më 31 dhjetor 2019, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Theksim çështje

Ne tërheqim vëmendjen për shënimin 26 të pasqyrave financiare, i cili përshkruan vlerësimin e menaxhimit në lidhje me ndikimin aktual dhe potencial të pandemisë së COVID - 19 dhe për arsyen e aplikimit të parimit të vijueshmërisë për përgatitjen e pasqyrave financiare. Opinioni ynë nuk është modifikuar në lidhje me këtë çështje.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likujdijë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.



Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënime shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënime shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

29 maj 2020

Teit Gjini
Auditues Ligjor

MAZARS
Rr. Emin Duraku, Pall. "Binjaket",
Nr. 1000, Tiranë, Albania
phone: +355 42 27 80 15
www.mazars.al | info@mazars.al

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR
më 31 dhjetor 2019

	Shënime	31 dhjetor 2019
AKTIVE		
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to	11	11,384,558
Depozita me afat me bankat	6	372,256,710
Llogari të arkëtueshme sigurimi, neto	8	2,077,607
Aktive të risigurimit	7	290,966
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	10	9,373,174
Inventari	9	10,000
Kosto të shtyra të marrjes në sigurim	13	372,270
Aktive afatgjata material	4	271,583
Aktive afatgjata jomateriale	5	120,120
Aksione në shoqëri të lidhura	12	32,000,000
Totali i aktiveve		428,156,988
DETYRIMET		
Rezervat për primet e pafiturar	14	1,660,722
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura	15	19,254,940
Detyrim tatim fitimi	23	535,524
Detyrime te tjera	16	1,681,164
Totali i detyrimeve		23,132,350
KAPITALI		
Kapitali aksionar	17	402,000,000
Fitimi i ushtrimit	23	3,024,638
Totali i kapitalit		405,024,638
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		428,156,988

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 29, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE GJITHPËRFSHIRËSE
për periudhën 13 shtator 2019 deri më 31 dhjetor 2019

	Shënime	Për periudhën 13 shtator 2019 deri më 31 dhjetor 2019
Prime të shkruara bruto	18	7,064,844
Prime të çeduar në risigurim		-
Prime të shkruara neto		7,064,844
Ndryshimi në rezervën e primeve të pafituara	14	(1,660,722)
Ndryshimi në shpenzime të shtyra	13	372,270
Ndryshimi në rezervën e primit të risiguruesit	7	290,966
Të ardhura neto nga primet e sigurimit		6,067,358
Të ardhura nga tarifat dhe komisionet		-
Të ardhura nga interesi	19	1,582,312
Të ardhura të tjera		-
Të ardhura të tjera		1,582,312
Të ardhurat neto		7,649,670
Kostot e marrjes në sigurim	20	(1,619,425)
Shpenzimet administrative	21	(3,140,966)
Shpenzime financiare neto	22	670,883
Total shpenzime operative		(4,089,508)
Fitimi i vitit para tatimit		3,560,162
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		(535,524)
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	23	(535,524)
Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë		-
Fitimi/humbja e vitit		3,024,638
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		3,024,638

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 29, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Albsig Jetë sh.a
(Vlerat janë në Lek)

**PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL
13 shtator 2019 deri më 31 dhjetor 2019**

	Kapitali aksionar	Fitimi i mbartur	Fitim i vitit	Totali
Pozicioni financiar më 13 shtator 2019	-	-	-	-
Emetimi i kapitalit aksionar	402,000,000		3,024,638	405,024,638
Transferim në fitime të mbartura		-	-	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2019	402,000,000	-	3,024,638	405,024,638

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Drejtimi i Shoqërisë më ___ maj 2019 dhe janë firmosur nga:


Z. Ervin Spahiu
Drejtor i Përgjithshëm


Z. Irfan Lami
Drejtor i Financës

Politikat kontabël dhe Shënimit nga faqja 7 deri ne faqen 29 janë pjesë përbërëse, dhe duhet të lexohen së bashku me këto pasqyra financiare.

Albsig Jetë sh.a

(Vlerat janë në Lek)

PASQYRA E FLUKSIT TË PARASË
13 shtator 2019 deri më 31 dhjetor 2019

Shënime	Për periudhën 13 shtator 2019 deri më 31 dhjetor 2019
Flukset monetare nga aktivitetet operative	
Fitimi neto para tatimit	3,560,162
Rregullime për zërat jo-monetare në fitim ose humbje:	
Zhvlerësimi dhe amortizimi	5,238
Të ardhurat nga interesi	(1,582,312)
Humbje nga kembimet valutore	
Fitimi operativ para ndryshimeve në kapitalin qarkullues	1,983,088
Ndryshimet në	
Llogari të arkëtueshme bruto nga sigurimi	(2,077,607)
(Rritje)/Rënie në llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	(9,373,174)
Aktive të lidhura me risigurimin	(290,966)
Kosto të shtyra të marrjes në sigurim	(372,270)
Rritja në aktive të tjera	(10,000)
Rritje/(Rënie) në llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	19,254,940
Rritje/(Rënie) në detyrime të tjera	1,681,164
Rritje në rezervat e primit të pafituar	1,660,722
Rritje në rezervat teknike për dëmet	
Fluksi monetar gjeneruar nga veprimtaria operative	12,455,897
Tatimi fitimi i paguar	-
Interesi i paguar	-
Interesi i arkëtuar	-
Fluksi monetar neto i gjeneruar nga veprimtaria operative	12,455,897
Flukset monetare nga aktivitetet investuese:	
Blerje të aktiveve afatgjata material	(271,583)
Blerje të aktiveve afatgjata jo material	(125,358)
Rënie\Rritja në investime	(370,674,398)
Investime në shoqëri të lidhura	(32,000,000)
Fluksi monetar neto i përdorur nga veprimtaria investuese	(403,071,339)
Fluksi monetare nga veprimtaritë e financimit	
Emetimi kapitalit aksionar	402,000,000
Fluksi monetar neto i përdorur nga veprimtaritë e financimit	402,000,000
Ndryshimi neto në mjetet monetare dhe ekuivalentë bankë	11,384,558
Mjetet monetare dhe ekuivalentë në fillim të vitit	-
Mjetet monetare dhe ekuivalentë në fund të vitit	11,384,558

11

Politikat kontabël dhe Shënime nga faqja 7 deri në faqen 29 janë pjesë përbërëse, dhe duhet të lexohen së bashku me këto pasqyra financiare.

SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Albsig Jetë sh.a. ("Shoqëria") është themeluar më 2 korrik 2019 si një shoqëri sigurimi me seli në Tiranë në adresën Rruga e Barrikadave, (Pallatet 9 Katëshe) Nr.1001. Shoqëria është një shoqëri aksionare, e regjistruar sipas ligjit nr.7638, datë 19 nëntor 1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit më 19 korrik 2019 me numer identifikimi L92019017V.

Shoqëria operon sipas licensës nr.13 të lëshuar nga Autoriteti Mbikëqyrjes Financiare ("AMF"), për tregtimin të ushtruar veprimtari sigurimi jete sipas rregullave të AMF-së në territorin e Republikës së Shqipërisë. Autorizimi për të ndërmarrë aktivitetet e sigurimit të jetës është marrë më datë 13 shtator 2019. Aktivitetet kryesore të biznesit përfshijnë dhënien e shërbimeve të sigurimit për sigurim jetë-vdekje, sigurim martesë-lindje, sigurim jete i lidhur me fondet e investimit, sigurim i administrimit të fondeve kolektive, sigurim shtesë.

Kapitali i Shoqërisë është 402,000 mijë Lek i ndarë në 402,000 aksione me vlerë nominale 1,000 Lke/aksion e zotëruar 100% nga Albsig sh.a.

Më 31 dhjetor 2019, Shoqëria ka patur mesatarisht 4 punonjës dhe drejtues.

Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë gjatë vitit 2019 deri në nënshkrimin e këtyre pasqyrave financiare janë:

- Plarent Hamzaj - Kryetar
- Redi Ujkashi-Anëtar
- Klodian Gjonaj - Anëtar

2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE

2.1. Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur në përputhje me *Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar* ("SNRF") të lëshuara nga *Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit* (BSNK) dhe interpretimet e lëshuara nga *Komiteti Ndërkombëtar i Interpretimeve të Raportimit Financiar* ("KIRFN"). Pasqyrat financiare bashkëlidhur janë përgatitur në përputhshmëri me kërkesat rregullatore.

2.2. Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të parimit të kostos historike.

2.3. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimit

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtuesit të kryejnë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë aplikimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Vlerësimet dhe bazat e llogaritjes rishikohen vazhdimisht. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimet rishikohen dhe në periudha të ardhshme që rishikimi ndikon.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe janë bazuar në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë, përfshirë edhe pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme, të cilët besohet se janë të përshtatshëm dhe relevant për rrethanat aktuale.

Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën gjatë së cilës vlerësimi është rishikuar nëse rishikimi ndikon vetëm atë periudhë kontabël ose në periudhën gjatë së cilës vlerësimi është rishikuar dhe periudha të ardhshme nëse rishikimi ndikon të dyja periudhat si aktuale dhe të ardhshme.

2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE (VAZHDIM)

2.3 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimit (vazhdimi)

Humbja nga zhvlerësimi i të arkëtueshmeve

Shoqëria rishikon llogaritë e arkëtueshme të sigurimit dhe të tjera për të vlerësuar zhvlerësimin në baza vjetore. Në përcaktimin nëse një humbje nga zhvlerësimi duhet të regjistrohet në fitim ose humbje, shoqëria bën gjykime nëse ka ndonjë të dhënë të dukshme që tregojnë se ka një rënie të matshme në flukset e ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare nga një grup llogarish të arkëtueshme para rënies që mund të jetë identifikuar me një debitor individual në atë portofol. Kjo evidencë mund të përfshijë të dhëna që tregojnë se ka pasur një ndryshim negativ në statusin e pagesave të debitorit që lidhen me mungesat në aktivet në grup. Menaxhimi i shfrytëzon vlerësimet bazuar në përvojën historike të humbjeve për aktivet me karakteristika të rrezikut të kredisë dhe evidenca objektive të zhvlerësimit të ngjashme me ato në portofol kur cakton flukset e ardhshme të parasë.

Gjykime dhe vlerësime mbi efektet e pandemisë në parimin e vijimësisë

Ndërsa situata pandemike COVID-19 ende po evoluon në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Si pasojë, menaxhimi nuk është në gjendje të vlerësojë me siguri dhe të sigurojë një vlerësim sasior të ndikimit të mundshëm të kësaj pandemie në kompani. Ndërsa masat kufizuese kanë filluar të lehtësohen, volumi i shitjeve, fluksi i parasë, dhe fitimi mund të ndikohen. Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare, kompania po operon, vazhdon të përmbushë detyrimet e saj në kohën e duhur dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë parimin e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare.

Vlerësimi për primet e pafituara dhe detyrimet e kontratave të sigurimit

Për llogaritjen e provigjonit të primit të pafituar të Debitorit është përdorur Tabela e Vdekshmërisë e marrë nga INSTAT, e cila i ka tarifat më të larta sesa tarifat e miratuara dhe të rëna dakort nga risiguruesi. Kjo është bërë për të qenë sa më prudent. Tabela e vdekshmërisë është zbatuar vetëm për shumën e siguruar për Jetën. Për shumën e siguruar nga Aksidentet është përdorur metoda e ditëve ekzakte mbi primin bruto të sigurimit. Për llogaritjen e provigjonit të primit të pafituar për kontratat e tjera të sigurimit, përveç debitorit është përdorur metoda e ditëve ekzakte mbi primin bruto të sigurimit.

Shoqëria vlerëson rezervat IBNR në kontratat afatshkurtra të sigurimit të jetës. IBNR për llogaritjet mbi bazën e dëmeve të ndodhura. Shoqëria ka vetëm 3 muaj që zhvillon aktivitetin e saj. Gjatë kësaj periudhe nuk ka patur asnjë dëm të raportuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë të prezantuara në Lek, që është dhe monedha funksionale e Shoqërisë. Përveç rasteve ku specifikohet ndryshe, informacioni financiar është i prezantuar në Lek.

3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL

Politikat kontabël të vendosura më poshtë janë aplikuar në përputhje me të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare dhe janë aplikuar nga Shoqëria.

a) Transaksione në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale sipas kursit të këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit, kthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportimit, me përjashtim të diferencave në zërat monetarë të huaj që janë pjesë e një investimi neto në një operacion të huaj.

Diferencat që lindin nga kurset e këmbimit njihen në të ardhura ose humbje.

Kurset e këmbimit të përdorura më 31 dhjetor 2019 janë kurset zyrtare të Bankës së Shqipërisë (Lek ndaj monedhave të huaja) të paraqitura si më poshtë.

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2019
USD/ LEK	108.64
EUR/ LEK	121.77

b) Klasifikimi i kontratave të sigurimit dhe investimeve (detyrimet)

Kontratat nën të cilat Shoqëria pranon të marrë një rrezik sigurimi të rëndësishëm nga një palë tjetër (policë-mbajtësi) duke rënë dakort të kompensojë policë-mbajtësin ose përfitues të tjerë për një ngjarje të caktuar të pasigurtë (ngjarja siguroese) e cila ka efekte negative dhe ndikon në policë-mbajtësin apo përfituesit e tjerë, klasifikohet si kontratë sigurimi. Rreziku i sigurimit është i ndryshëm nga rreziku financiar. Rreziku financiar është rreziku i ndryshimeve të mundshme të ardhshme në një ose më shumë nga norma interesi specifike, çmimet e letrave me vlerë, çmimet e komoditeteve, kursi i këmbimit, indekset e çmimeve ose të normave, vlerësimi i aftësisë kredituese apo indekset e kreditimit ose variabla të tjerë, të siguruar në rastin e variablave jo-financiare kur variabli nuk është specifik për një palë në kontratë. Kontratat e sigurimit mund të transferojnë një pjesë të rrezikut financiar.

Kontratat e investimit janë ato kontrata që transferojnë rrezik të rëndësishëm financiar, por jo rrezik të rëndësishëm sigurimi. Rreziku financiar është rreziku i ndryshimeve të mundshëm në të ardhmen në një ose më shumë variabla të ndryshme (si norma e interesit, çmimet e letrave me vlerë, kursi i këmbimit, indekset e çmimeve ose të normave, ose variabla të tjerë) me kushtin që në rastin e variablave jofinanciar variabli të mos jetë specifik për një prej palëve në kontratë.

Pasi një kontratë është klasifikuar si një kontratë sigurimi, mbetet një kontratë sigurimi për pjesën e mbetur të jetës së saj, edhe nëse rreziku i sigurimit zvogëlohet ndjeshëm gjatë kësaj periudhe, përveç nëse të gjitha të drejtat dhe detyrimet shuhen ose skadojnë. Megjithatë, kontratat e investimit mund të rriklassifikohen si kontrata sigurimi pas krijimit nëse rreziku i sigurimit bëhet i rëndësishëm.

c) Njohja dhe matja e kontratave të sigurimit (detyrimet)

i. Primet

Primet për sigurimin e jetës - afatshkurtra

Primet e shkruara bruto përfshijnë shumat e përfituara nga polica ose kontrata sigurimi të lidhura gjatë vitit financiar në lidhje me sigurimin e drejtpërdrejtë, pavarësisht nga fakti se shumat të tilla mund të lidhen tërësisht apo pjesërisht me një periudhë të mëvonshme në kontabilitet. Primet paraqiten bruto përfshirë komisionet e ndërmjetësve dhe taksat e bazuara në prime. Pjesa e fituar e primeve të pranuar njihet si e ardhur. Primet janë të fituara nga data e marrjes përsiper të rrezikut, përgjatë periudhës së sigurimit, bazuar në modelin e rrezikut të nënshkruar.

3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

c) Njohja dhe matja e kontratave të sigurimit (detyrimit) (vazhdim)

i. *Primet (vazhdimi)*

Primet për sigurimin e jetës - afatgjata

Për kontratat e sigurimit që kontraktohen me debitorë të Bankave të nivelit të dytë në Shqipëri, dhe që kanë afat disa vjeçar, për mbulimin e kredisë gjatë afatit të shlyerjes së saj, Shoqëria njihet në të ardhura primin e shkruar bruto vjetor në momentin që lëshon kontratën e sigurimit.

Për kontratat afatgjata për të cilat Shoqëria arkëton primin në total për të gjithë afatin e kontratës, pjesa e mbetur e kontratës afatgjatë të sigurimit me debitorët, që nuk është njohur në periudhën raportuese pasqyrohet si angazhim i Shoqërisë për vitet e ardhshme.

Rezerva për primin e pafituar

Primet e pafituara përfshijnë atë pjesë të primeve të shkruara bruto, me periudhat e rrezikut pas datës së raportimit. Primet e marra janë llogaritur në baza ditore pro rata. Primi i pafituar llogaritet nga prime të shkruara bruto, dhe shtyhet për t'u njohur në periudhat pasardhese si rezervë për primet e pafituara. Për llogaritjen e rezervës së primin të pafituar janë marrë në konsideratë kontratat e shitura për të gjitha linjat e biznesit të jetës. Në llogaritjen e rezervës së primin të pafituar është përdorur metoda e ditëve ekzakte mbi primin bruto të sigurimit dhe nuk janë konsideruar në llogaritjet për rezervën e primin të pafituar policat e kthyer apo anuluar, me përjashtim të produktit të Jetës së Debitorit, për të cilin rezerva e primin është llogaritur me metodat aktuariale për provigjonet, duke marrë në konsideratë shumën e sigurimit të jetës së debitorit si dhe tabelat e mortalitetit për cdo moshë dhe gjini.

Primet e risigurimit

Primet e risigurimit njihen si shpenzim në përputhje me modelin e shërbimit të marrë nga risiguruesi. Nëse një policë sigurimi anulohet, primi i mbetur për t'u paguar përfshihet në të ardhurat nga primet. Lëvizja e detyrimeve nga sigurimi, nëse ka ndonjë, njihet si e ardhur neto e pjesës së risiguruesit. Shoqëria ka marrëveshje risigurimi për ekspozimet e sigurimit të Jetës së Debitorit.

Të ardhura nga investimet

Të ardhurat nga interesi për letrat me vlerë dhe depozitat njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes, në masën proporcionale që i takon periudhës raportuese dhe llogariten duke përdorur metodën e Normës Efektive të Interesit (NEI). Tarifat dhe komisionet që janë pjesë përbërëse e yield-it efektiv të aktivitetit financiar njihen si një rregullim në NEI të instrumentit.

Shoqëria ka investime në depozita dhe në shoqërinë e kontrolluar Albsig Invest.

Kostot e shtyra të marrjes në sigurim

Kostot e drejtpërdrejta dhe indirekte të krijuara gjatë periudhës financiare që rrjedhin nga blerja ose ripërtëritja e kontratave të sigurimit, shtyhen deri në masën që këto kosto janë të rikuperueshme nga primet e ardhshme nga kontrata e sigurimit. Të gjitha shpenzimet e tjera të blerjes njihen si shpenzime kur ndodhin.

Kostot e shtyra të marrjes në sigurim dhe të ardhurat e shtyra nga komisionet përfaqësojnë përqindjen e kostove të ndodhura të marrjes në sigurim dhe të ardhurave që korespondojnë me rezervën e primin të pafituar. Të ardhurat shtyhen dhe njihen si të ardhura kur shërbimet përkatëse do ofrohen dhe njihen në pasqyrën e fitim humbjes së vitit.

ii. *Dëmet*

Dëmet që rrjedhin nga kontratat e sigurimit të jetës

Dëmet përbehen nga pagesat e bëra gjatë vitit financiar së bashku me ndryshimin në rezervën për dëmet. Dëmet bruto të paguara përfshijnë të gjitha shpenzimet e bëra për këto dëme. Rikuperimet në avancë nga risigurimi paraqiten më vete si aktive. Rikuperimet nga risigurimi dhe të tjera vlerësohen në mënyrë të ngjashme me vlerësimin e dëmeve pezull.

Në muajt e parë të aktivitetit të saj shoqëria nuk ka patur dëme të raportuara dhe nuk ka kryer pagesa për dëme.

3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

c) Njohja dhe matja e kontratave të sigurimit (detyrimit) (vazhdim)

ii. Dëmet (vazhdim)

Rezerva për dëmet

Rezerva për dëmet janë shumat e të gjitha dëmeve që kanë lindur gjatë periudhës financiare aktuale dhe asaj të mëparshme të cilat nuk janë paguar në përfundim të vitit fiskal. Rezerva përfshin edhe dëmet e ndodhura, por të paraportuara (IBNR) në atë datë (shenimi b)

a) *Rezerva per dëmet* – RBNS: Për përlogaritjen e rezervës së dëmeve është përdorur metoda "Rast pas Rasti" mbështetur në vlerën e rezervës të llogaritur nga specialisti i dëmeve. Gjatë muajve të operimit shoqëria nuk ka patur asnjë dëm të raportuar.

b) *Rezerva për dëmet* – IBNR: Duke konsideruar që Shoqëria nuk ka patur asnjë dëm të raportuar nuk është i mundur aplikimi i metodës së trekëndëshit për vlerësimin e IBNR derisa të ketë një historik dëmsh për aplikimin e kesaj metode. Shoqëria pret të përlogarisë IBNR në varësi të dëmeve të raportuara.

Risigurimi

Shoqëria cedon risigurimin në rrjedhën normale të biznesit me qëllim që të limitojë humbjen neto nëpërmjet diversifikimit të rrezikut. Marrëveshjet e risigurimit nuk i heqin Shoqërisë detyrimet ndaj policëmbajtësve. Primet e ceduara dhe përfitimet e rimbursimit paraqiten në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse dhe pasqyrën e pozicionit financiar me baza bruto. Kontratat nga të cilat lind një transferim i rrezikut të sigurimit kontabilizohen si sigurim. Shumat e rigjeneruara nga këto kontrata njihen në të njëjtin vit me dëmin.

Aktivet e risiguara përfshijnë balanca detyrimi nga shoqëria risiguroese për detyrimet e primeve të ceduara si dhe shuma të rikuperueshme nga dëmet e paguara. Këto shuma, nëse ka të tilla, klasifikohen si shuma të arkëtueshme dhe paraqiten në pasqyrat financiare. Llogaritë e arkëtueshme nga kontratat e risigurimit përfshijnë komisionet e risigurimit nga primet e ceduara të risiguroesit dhe të arkëtueshmet nga shoqëria risiguroese në përputhje me dëmin e paguar. Keto klasifikohen si llogari të arkëtueshme dhe paraqiten të veçanta. Aktivët e risigurimit vlerësohen për zhvlerësim në çdo datë raportimi. Këto aktive zhvlerësohen nëse ka evidencë objektive, si pasojë e një ngjarje që ka lindur pas njohjes fillestare, për të cilat Shoqëria nuk mund të rimarrë të gjitha shumat që i detyrohen dhe për një ngjarje e cila ka një impakt të matur në mënyrë të besueshme për shumat të cilat Shoqëria do të marrë nga risiguroesi.

iii. Testi i mjaftueshmërisë së detyrimeve

Në çdo datë raportimi shoqëria kryen testimin për tu siguruar për mjaftueshmërinë e rezervave të dëmeve. Testimet kryesore që kryen janë: Analiza e Raportit të Dëmeve dhe Analiza e Zhvillimit të Provigjoneve të Dëmeve.

Analiza e raportit të dëmeve kryhet çdo vit dhe individualisht në pjesën më të madhe të linjave të biznesit. Llogaritja bëhet vetëm mbi dëmet që përfshijnë edhe koston e marrjes në sigurim dhe kosto të tjera të jashtme të lidhura me dëmin. Në kryerjen e kësaj analize shoqëria merr në konsideratë parashikimet aktuale të rrjedhjeve dalëse të parasë. Shoqëria nuk i skanton këto flukse të parashikuara të parasë pasi shumica e dëmeve priten të paguhen brenda vitit.

Në vazhdim, shoqëria kryen një analizë vjetore të zhvillimit të provigjionimit të dëmeve për vlerësimin e metodologjisë së provigjionimit. Kjo analizë kryet mbi RBNS dhe IBNR në baza individuale dhe të kombinuara. Në rast se analiza shfaq mospërputhje të madhe, korrigjimet e duhura bëhen në metodën e provigjionimit. Nëse identifikohet një pamjaftueshmëri e rezervave, ajo do t'i ngarkohet menjëherë shpenzimeve duke krijuar një rezervë risku të paskaduar nga humbjet që rezultojnë nga Testi i Mjaftueshmërisë së Rezervave.

3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

d) Instrumentet financiare

(i) Njohja

Shoqëria fillimisht njih investimet dhe depozitat në datën kur lindin të drejtat dhe detyrimet përkatëse. Të gjitha detyrimet dhe aktivet financiare njihen në datën e transaksionit sipas së cilit Shoqëria bëhet palë e detyrimeve kontraktore të instrumentit.

(iii) Çregjistrimi

Shoqëria çregjistron një aktiv financiar nëse humbet kontrollin mbi flukset e ardhshme të parasë ose transferon të drejtat për të marrë flukset kontraktuale të parasë nga aktivet financiare në transaksione në të cilat i gjithë rreziku dhe përfitimet nga aktivet financiare është transferuar. Çdo interes nga aktivi financiar i transferuar që është krijuar ose mbajtur nga Shoqëria njihet si aktiv ose detyrim i veçantë. Shoqëria çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale shuhet, anulohen ose maturohen.

(iv) Netimi

Aktivitet dhe detyrimet financiare mund të netohen dhe tepricat neto të paraqiten në bilanc vetëm kur Shoqëria ka të drejta ligjore për të netuar shumat dhe ka qëllim të ardhshëm të arkëtojë ose të mbyllë aktivin apo detyrimin neto në të njëjtën kohë. Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten të netuara kur lejohet nga Standartet e Kontabilitetit, ose për fitime dhe humbje që lindin nga transaksione me natyrë të njëjtë përgjatë aktivitetit të Shoqërisë.

(v) Matja me kosto të amortizuar

Kosto e amortizuar e një aktivi financiar është vlera me të cilën aktivi financiar ose detyrimi financiar është matur në njohjen fillestare, duke zbritur këstet e paguara, plus ose minus amortizimin kumulativ që rezulton nga përdorimi i metodës së interesit efektiv duke marrë parasysh ndonjë diferencë midis vlerës së njohur në fillim dhe vlerës në maturim si dhe humbjet nga rënia në vlerë.

(vi) Matja me vlerë të drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare është bazuar në çmimet e publikuara të tregut dhe treguesve të instrumentave financiare në tregjet aktive. Për të gjitha instrumentet financiare të tjera vlera e drejtë është përcaktuar duke përdorur teknika vlerësimi. Teknikat e vlerësimit përfshijnë teknika të tilla si vlera reale neto, metoda e aktualizimit të flukseve, krahasimi me instrumenta të tjerë të ngjashëm për të cilat çmimet përcaktohen në tregje aktive si dhe modele të tjera vlerësimi.

(vii) Identifikimi dhe matja e rënies në vlerë

Në datën e përgatitjes së pasqyrave financiare Shoqëria vlerëson nëse ka evidenca objektive për rënie në vlerë të aktiveve financiare. Aktivitet financiare pësojnë rënie në vlerë kur evidenca objektive dëshmon që një ngjarje me pasojë humbje ka ndodhur pas vlerësimit të mëparshëm të aktivitet, si dhe kjo ngjarje ndikon në flukset e mjeteve monetare të vlerësueshme në mënyrë të besueshme.

Shoqëria merr në konsideratë evidenca për rënie në vlerë të aktiveve financiare specifike ose në grup të aktiveve. Të gjitha aktivet individualisht të rëndësishme testohen veçmas për humbjen e mundshme në vlerë, por që nuk është identifikuar ende. Të gjitha aktivet që nuk konsiderohen të jenë individualisht të rëndësishëm grupohen dhe vlerësohen së bashku me aktive me karakteristika të ngjashme (të mbajtura me kosto të amortizuar) për rënie në vlerë.

Si evidencë objektive për rënie në vlerë të mundshme të aktiveve në pasqyrat financiare mund të përmendet mosshlyerja në kohë apo shkelja e termave nga një debitor, ristrukturimi i një kredie/paradhënie të dhënë nga Shoqëria me terma të cilat në kushte të tjera nuk do të ishin konsideruar, tregues për falimentimin e mundshëm të një debitori ose të dhëna të tjera të dukshme lidhur me një grup aktivesh si ndryshimi në përkeqësim në statusin e arkëtueshmërisë së një debitori ose kreditori, apo kushte ekonomike që ndikojnë në përkeqësim të grupit të aktiveve.

3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

d) Mjetet monetare dhe ekuivalentë me to

Mjetet monetare dhe ekuivalentë me to përfshijnë balancat e gjendjes në arkë, mjetet monetare të depozituara në banka të nivelit të dytë dhe investime afatshkurtra me likuiditet të lartë dhe me maturitet deri në tre muaj ose më pak që nga momenti i blerjes.

e) Depozitat me afat

Depozitat me afat paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar me shumën e principalit të tyre dhe klasifikohen sipas maturitetit. Depozitat me afat me maturitet më të vogël se tre muaj klasifikohen si ekuivalentë të mjeteve monetare, ato me maturitet midis tre dhe dymbëdhjetë muaj klasifikohen si investime në depozita me afat.

f) Letra me Vlerë

Letrat me vlerë janë investime borxhi të cilat Shoqëria ka për qëllim dhe aftësi t'i mbajë deri në maturim dhe që janë klasifikuar si aktive të mbajtura deri në maturim. Investimet të cilat kanë pagesa fikse ose të përcaktuara dhe të cilat synohen të mbahen deri në maturim dhe si rrjedhim maten me kosto të amortizuar, minus provigjionin për rënien në vlerë. Kosto e amortizimit llogaritet duke marrë në konsideratë ndonjë skontim ose prim në blerje. Primet dhe skontimet në investimet e projektuara si të mbajtura deri në maturim amortizohen sistematikisht gjatë maturitetit duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe rregjistrohen si të ardhura nga interesi.

g) Llogaritë e arkëtueshme sigurimi dhe të tjera

Kreditë dhe të drejtat e tjera njihen në fillim me vlerë të drejtë dhe në vazhdim maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv minus provigjionin për zhvlerësim. Provigjioni për zhvlerësimin e kredive dhe të drejtave të tjera të arkëtueshme krijohet kur ka një evidencë objektive që shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumat sipas kushteve fillestare. Të drejtat e arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimit që vijnë nga mbajtësit e policave të sigurimit gjithashtu klasifikohen në këtë kategori dhe rishikohen për zhvlerësim si pjesë e rishikimit për zhvlerësim të kredive dhe të drejtave të tjera të arkëtueshme.

h) Njohja e të ardhurave

i. *Primet e shkruara bruto*

Primet e shkruara bruto janë njohur sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara për kontratat e sigurimit, policat e lëshuara gjatë vitit janë kredituar në të ardhura sipas realizimit proporcional duke u bazuar në termat e kontratës së sigurimit. Rezerva e primeve të pafituara përfaqëson pjesën e primeve të shkruara që lidhen me termat e mbulimit që nuk kanë skaduar.

ii. *Të ardhura nga interesi*

E ardhura nga interesi njihet në bazë të të drejtave të konstatuara mbi principalin pezull, dhe duke përdorur normën efektive të interesit.

iii. *Të ardhura nga tarifat dhe komisionet*

Të ardhurat nga komisioni dhe tarifat njihen me bazë rrjedhëse.

i) Shpenzimet

Shoqëria paguan vetëm kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore të cilat u sigurojnë punonjësve përfitime pensioni pas shkëputjes nga puna. Autoritetet lokale janë përgjegjëse për të përcaktuar kufirin e vendosur minimal për pensionet në vendet përkatëse sipas një plani të përcaktuar kontributësh pensioni. Kontributet e Shoqërisë për planin e pensionit paraqiten në pasqyrën përmbledhëse individuale të të ardhurave kur ndodhin.

3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

i. Shpenzimet operative

Shpenzimet operative njihen kur ato ndodhin.

ii. Përfitimet e punonjësve

Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore.

iii. Leja vjetore e paguar

Shoqëria njih si detyrim shumë të pa skontuar të kostove të parashikuara në lidhje me lejen vjetore që pritet të paguhet në shkëmbim të shërbimeve të punonjësve për periudhën e përfunduar. Për vitin 2019 punonjësit e shoqërisë i kanë përfunduar lejet e tyre vjetore.

iv. Pagesat e qirave operative

Pagesat e bëra për qiratë operative njihen në pasqyrën përmbledhëse individuale të të ardhurave në përpjesëtim me kohëzgjatjen e kontratës së qirasë.

v. Pagesat e qirave financiare

Pagesat e qirasë janë të ndarë midis pagesave financiare dhe uljes së detyrimit ndaj qirasë, për të arritur në një nivel konstant të interesit në tepricën e mbetur të detyrimit. Pagesat financiare janë njohur si kosto financiare në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

j) Llogari të pagueshme të sigurimit dhe të tjera

Llogaritë e pagueshme të sigurimit dhe të tjera mbahen me kosto.

k) Prona, ambjenti dhe pajisjet

Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afat-gjata materiale maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe çdo humbje tjetër nga zhvlerësimi përveç ndërtimeve në proces të cilat maten me vlerën e rivlerësuar. Kostoja historike përfshin shpenzime që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me blerjen e këtyre elementeve.

Kur pjesë të një aktivi kanë diferenca mbi jetëgjatësinë e dobishmërinë, ato njihen si aktive të ndara (komponentë të rëndësishëm) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitja përcaktohen duke krahasuar shumat e marra me vlerën e mbetur, dhe duke përfshirë diferencën në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave në zërin 'Fitime/(humbje) të tjera'.

Kostot e mëpasshme

Kostot e mëpasshme përfshirën në vlerën e aktivit ose njihen si një aktiv i veçantë vetëm kur është e mundshme që përfitimet të ardhshme do të rrjedhin nga ky aktiv dhe kostoja mund të matet në mënyrë të besueshme. Vlera kontabël e pjesës së zëvendësuar nuk njihet. Të gjitha riparimet dhe mirëmbajtja i ngarkohen fitimit dhe humbjes së periudhës financiare në të cilën ato kryhen.

3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**k) Prona, ambjenti dhe pajisjet (vazhdon)***Amortizimi*

Amortizimi për ndërtesat dhe përmirësimet e infrastrukturës llogaritet duke përdorur metodën lineare në përputhje me jetën e dobishme ekonomike të aktivitetit ndërsa amortizimi për zërat e tjerë të aktiveve llogaritet duke përdorur metodën me vlerën e mbetur në përputhje me jetën e dobishme ekonomike të aktivitetit. Toka dhe aktivet në ndërtim nuk amortizohen.

Amortizimi vjetor i aktiveve afatgjata materiale sipas jetëgjatësisë së dobishme të parashikuar për periudhën e mëparshme dhe aktuale paraqitet si më poshtë:

Kategoria	31 dhjetor 2019
Ndërtesa dhe përmirësime infrastrukture	5%
Makineri dhe pajisje	20%
Pajisje zyre	20%
Mjete transporti	20%
Mobilje dhe orëndi	20%
Pajisje kompjuterike dhe programe	25%

Vlera e mbetur, nëse nuk është e parëndësishme, duhet të rishikohet çdo vit. Përmirësimet teknike kapitalizohen dhe zhvlerësohen përgjatë afatit më të shkurtër midis afatit të qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

l) Aktivet afatgjata jomateriale

Aktivitet afatgjata jomateriale që janë të blera nga shoqëria, të cilat kanë një jetë të dobishme të kufizuar, vlerësohen me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe zhvlerësimet akumuluar. Norma e amortizimit është 15% bazuar në vlerën e mbetur të aktivitetit.

Shpenzimet e mëpasshme të aktiveve afatgjata jomateriale

Shpenzimet e mëpasshme kapitalizohen vetëm nëse shpenzimi rrit përfitimet e ardhshme ekonomike të trupëzuara në aktivitetin me të cilin ka të bëjë shpenzimi. Të gjitha shpenzimet, duke përfshirë shpenzime për emrin e mirë të gjeneruar nga shoqëria apo markat, njihen në të ardhura ose shpenzime kur ato ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi njihet në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave bazuar në vlerën e mbetur duke përdorur normat fiskale për amortizimin e aktiveve të trupëzuara, një muaj pas blerjes së aktivitetit. Jeta e dobishme e aktiveve rishikohet, dhe bëhen rregullimet e nevojshme, në çdo datë bilanci.

Fitimet dhe humbjet nga shitja përcaktohen duke krahasuar shitjet me vlerën e mbetur dhe diferencat përfshihen në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave.

m) Tatimi

Tatimi mbi fitimin është njohur në pasqyrën individuale të të ardhurave dhe shpenzimeve dhe paraqet shumën e tatimeve të pagueshme dhe të shtyra.

(i) Tatim fitimi aktual

Tatimi aktual është tatimi i pritshëm i pagueshëm mbi fitimin e tatueshëm të vitit, i cili llogaritet duke përdorur normat e tatimeve në fuqi në datën e raportimit dhe ndonjë rregullim të tatimit të pagueshëm në lidhje me vitet e mëparshme. Fitimi fiskal ndryshon nga fitimi neto i raportuar në pasqyrën individuale të të ardhurave dhe shpenzimeve sepse përjashton zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve që janë të tatueshme ose të zbritshme në vitet e tjera dhe gjithashtu përjashton zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve që nuk janë asnjëherë të tatueshme ose të zbritshme.

3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

m) Tatimi (vazhdon)

(ii) Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë kontabilizohet duke përdorur metodën e detyrimeve të bilancit kontabël dhe llogaritet si tatimi i pritur për tu paguar ose për tu arkëtuar nga diferencat e përkohshme midis vlerës së mbartur të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe vlerës së përdorur për qëllime fiskale. Shuma e tatimit të shtyrë të lejuar bazohet në mënyrën e parashikuar të realizimit ose pagesës të shumave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve, duke përdorur normat fiskale të miratuara ose që priten të miratohen me siguri në datën e raportimit.

(iii) Detyrimet e shtyra tatimore

Detyrimet e shtyra tatimore njihen për të gjitha diferencat e përkohshme dhe aktivet tatimore të shtyra njihen vetëm nëse është e mundur që në të ardhmen do të ketë përfitime fiskale kundrejt të cilave do të mund të shfrytëzohen diferencat e përkohshme. Aktivet tatimore të shtyra reduktohen kur nuk ka mundësi që përfitimet e lidhura tatimore do të realizohen. Tatimi i shtyrë llogaritet me normën e taksës që është parashikuar për tu zbatuar në periudhën kur detyrimi paguhet ose aktivi të realizohet dhe ngarkohet në pasqyrën përmbledhëse individuale të të ardhurave, përveç kur është e lidhur me zërat e ngarkuar direkt në kapital. Në të tilla raste tatimi i shtyrë është gjithashtu pjesë e kapitalit.

n) Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përbëhen nga aksionarë dhe drejtorët e shoqërisë, së bashku me entitete që ata kontrollojnë, të cilët mund të ushtrojnë influencë të konsiderueshme në operacionet dhe menaxhimin e shoqërisë. Duke konsideruar çdo palë të mundshme të tretë vëmendje i kushtohet thelbit të marrëdhënies dhe jo vetëm forma ligjore.

o) Ngjarjet pas datës së raportimit

Ngjarjet pas datës së bilancit që ofrojnë informacion shtesë për pozicionin e shoqërisë në datën e pasqyrës së pozicionit financiar (veprimet rregulluese), janë të reflektuara në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas datës së bilancit që nuk janë ngjarje për veprime rregulluese janë pasqyruar në shënimet shpjeguese kur janë materiale.

p) Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato pasqyrohen në shënimet shpjeguese nëse mundësia e konsumimit të burimeve që kanë përfitime ekonomike është e ulët. Aktivet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare por paraqiten në shënimet sqaruese kur mundësia e të ardhurave ekonomike është e mundshme.

Shuma e humbjes së kushtëzuar njihet si provigjon nëse është e mundshme që ngjarje të ardhshme do të konfirmojnë provigjonin, një detyrim njihet në ditën e pasqyrës së pozicionit financiar kur një vlerësim i pranueshëm i humbjes mund të bëhet në mënyrë të besueshme.

q) Standarde dhe Interpretime në fuqi në periudhën raportuese (vazhdim)

Aplikimi i SNRF 16 Qiratë

SNRF 16, Qiratë (lëshuar me 13 janar 2016 dhe efektive për periudhat vjetore duke filluar nga ose pas 1 janar 2019). Standardi i ri vendos parimet për njohjen, paraqitjen dhe shënimet shpjeguese të qirasë. Të gjitha qiradhënjet pothuajse rezultojnë që qiramarrësi të fitojë një të drejtë përdorimi të një aktivi në fillim të qerasë, dhe nëse pagesat e qerasë bëhen me kalimin e kohës, edhe marrja e financimit. Sipas SNRF 16, eliminon klasifikimin e qirasë si qera operationale ose qera financiare sic kërkohet në SNK 17 dhe, në vend të saj prezanton një model të vetëm të kontabilitetit të qiramarrësit. Qiramarrësit do të kërkohet të njohë: (a) aktive dhe detyrime për të gjitha qeratë me afat më shumë se 12 muaj, përveç rasteve kur aktivi ka vlerë të ulët; dhe (b) amortizimin e aktiveve të qerasë të ndarë nga interesi i detyrimit të qerasë në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse. SNRF 16 trajton në të njëjtën mënyrë kontabël rastin e qiradhënësit si në SNK17.

Shoqëria nuk ka patur impakt në lidhje me SNRF 16, pasi nuk ka asnjë kontratë qeraje aktive.

3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

r) Standardet e reja dhe interpretimet të cilat nuk janë adoptuar akoma

Standardet e amenduara më poshtë janë bërë efektive për kompaninë nga 1 janar 2019, por nuk kanë pasur asnjë impakt material në kompani:

- Interesi afatgjatë në partnership dhe joint ventures – Amendimet e SNK
- Përmirësimet vjetore të ciklit të SNRF 2015- 2017
- Plani i ndryshimit ose zgjidhjes – Amendimet në SNK 19
- Interpretimi 23 Pasiguria mbi trajtimin e tatimit të të ardhurave
- KIRFN 23 Pasiguria mbi pozicionet e tatimit mbi të ardhurat (efektive nga 1 janar 2019)
- Përmirësimet vjetore (cikli 2015 -2017) (detyrimisht efektive për periudhën që fillon me 1 janar 2019)
- Amendimet në SNRF 9 Karakteristikat e parapagimit me kompensim negative (efektive nga 1 janar 2019)
- Amendimet në SNK 19 "Planet e ndryshimit, mbylljes ose zgjedhjes"(detyrimisht efektiv për periudhat nga ose pas 1 janar 2019)
- Amendimet në SNK 28 "Interesi afatgjatë në partnership dhe joint ventures" (detyrimisht efektiv për periudhat me ose pas 1 janar 2019)
- SNRF 17 "Kontratat e sigurimit" (detyrimisht efektiv për periudhat me ose pas 1 janar 2023)

s) Standardet dhe interpretimet të cilat nuk janë adoptuar akoma

Standardet dhe interpretimet e mëposhtme janë lëshuar por nuk janë të detyrueshme për periudhën aktuale të raportimit të mbyllur me 31 dhjetor 2019:

- SNRF 17 Kontratat e sigurimeve – lëshuar në maj 2017 si zëvendësim i SNRF 4 Kontratat e sigurimeve – efektive për periudhat pas 1 janar 2023
- Amendimet e SNK 1 dhe SNK 8 – efektive për periudhat pas 1 janar 2020
- Amendimet e SNRF 3 – efektive për periudhat pas 1 janar 2020
- Kuadri konceptual i rishikuar për Raportimin Financiar – efektiv për periudhat pas 1 janar 2020

Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit ka lëshuar disa standarde dhe interpretime që janë efektive me periudhat e ardhshme kontabël, të cilat kompania ka vendosur mos ti aplikojë paraprakisht. Kompania planifikon ti aplikojë këto standarde dhe interpretime kur ato të bëhen efektive.

SNRF 17 "Kontratat e Sigurimit" u botua në 18 maj 2017 me një datë efektive të 1 janarit 2021 (aplikim retrospektiv). SNRF 17 siguron udhëzime gjithëpërfshirëse për kontabilitetin e kontratave të sigurimit dhe kontratave të investimeve. Për kontratat e sigurimit të jo-jetës, SNRF 17 prezanton skontimin e detyrueshëm të rezervave të humbjes, si dhe rregullimi i rrezikut , për rrezikun jofinanciar, për të cilin do të kërkohet shpalosja në shënime e nivelit të besimit. Më tej, SNRF 17 do të ndryshojë prezantimin e të ardhurave nga kontrata e sigurimit, si Primi i shkruar bruto nuk do të paraqitet më në pasqyrat e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

Për kontratat e sigurimit të jo-jetës, pritet të ketë një ndikim të rëndësishëm në modelimin aktuarial si parashikimet e flukseve të parave dhe ndryshimet në supozime do të kërkohen të paraqiten ose në luhatshmeri të fitim/humbjeve ose në marzhin e shërbimit të kontraktuar, si një element i veçantë i detyrimeve për sigurim që do të përfaqësojë fitimet e papërfituara nga kontratat në fuqi.

Në shtator 2016, IASB amendoi SNRF 4 duke prezantuar një përjashtim të përkohshëm nga implementimi i SNRF 9 për subjektet raportuese që nuk kanë aplikuar më parë asnjë version të SNRF 9 dhe aktivitetet e të cilëve janë kryesisht të lidhura me sigurimet. Ky përjashtim e lejon Shoqërinë të vazhdojnë aplikimin e SNK 39-ës Instrumentat financiare: Njohja dhe Matja, ndërkohë që shtyn aplikimin e SNRF 9-ës deri në implementimin e SNRF 17.

Albsig Jetë sh.a
Shënime mbi Pasqyrat Financiare për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2019
(Vlerat janë në Lek)

4. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

Aktivët afatgjata materiale më datë 31 dhjetor 2019 janë paraqitur si më poshtë:

	Pajisje zyre	Pajisje informatike	Totali
Kosto			
Gjendja më 13 shtator 2019	-	-	-
Shtesa	228,883	42,700	271,583
Pakësime	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2019	228,883	42,700	271,583
Amortizimi i akumuluar			
Gjendja më 13 shtator 2019	-	-	-
Amortizimi	-	-	-
Pakësime	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2019	-	-	-
<i>Vlera neto kontabël</i>			
Gjendja më 31 dhjetor 2019	228,883	42,700	271,583

Në 31 dhjetor 2019, Shoqëria nuk ka barrë mbi pronat, objektet dhe pajisjet.

5. AKTIVE AFATGJATA JOMATERIALE

Aktivët afatgjata jomateriale përfshijnë programe kompjuterike të cilat janë detajuar si më poshtë:

	Programe kompjuterike
Kosto	
Gjendja më 13 shtator 2019	-
Shtesat	125,358
Gjendja më 31 dhjetor 2019	125,358
Zhvlerësim i akumuluar	
Gjendja më 13 shtator 2019	-
Amortizim	5,238
Gjendja më 31 dhjetor 2019	5,238
<i>Vlera neto kontabël</i>	
Gjendja më 31 dhjetor 2019	120,120

6. DEPOZITA ME AFAT ME BANKAT

Investimet me bankat dhe institucionet financiare më 31 dhjetor 2019 janë të detajuara si më poshtë:

	31 dhjetor 2019
Depozita për fondin e garancisë	370,674,400
Interesi i përlogaritur	1,582,310
	372,256,710

Fondi i garancisë përbëhet nga depozitat bankare të bllokuara pranë bankave të nivelit të dytë në Republikën e Shqipërisë dhe nuk është disponibël për operacione të përditshme. Depozitat me bankat përfshijnë depozita bankare të tjera me maturitet më shumë se 12 muaj.

6. DEPOZITA ME AFAT ME BANKAT(VAZHDIM)

Detajimi i depozitave me afat sipas bankave është si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>
Banka e Tiranës	90,000,000
Banka Amerikane e Investimeve	90,000,000
Banka Kombëtare Tregtare	90,000,000
ProCredit Bank	100,674,400
	<u><u>370,674,400</u></u>

7. AKTIVE TË RISIGURIMIT

Rezerva e risigurimit më 31 dhjetor 2019 përbëhet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>
Aktive të risigurimit- sigurimi jetës së debitorit	290,966
	<u><u>290,966</u></u>

8. LLOGARI TË ARKËTUESHME SIGURIMI,NETO

Llogarite e arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimit përbëhen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>
Të arkëtueshme nga klientët-policëmbajtës	2,077,607
	<u><u>2,077,607</u></u>

9. INVENTARI

Inventari më 31 dhjetor 2019 detajohet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>
Inventari i policave	10,000
	<u><u>10,000</u></u>

10. LLOGARI TË ARKËTUESHME NGA PALËT E LIDHURA

Të arkëtueshme nga palët e lidhura deri më 31 dhjetor 2019 janë si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>
Llogari të arkëtueshme nga Albsig-Invest	9,373,174
	<u><u>9,373,174</u></u>

11. MJETE MONETARE NË ARKË DHE NË BANKË

Mjete monetare në arkë dhe bankë më 31 dhjetor 2019 janë si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>
Mjete monetare në arkë	-
Mjete monetare në bankë	11,384,558
<i>Mjete monetare në bankë në monedhë të huaj</i>	<i>8,143,552</i>
<i>Mjete monetare në bankë në monedhë vendase</i>	<i>3,241,006</i>
	<u>11,384,558</u>

Paraja në bankë përfshin llogari rrjedhëse. Mjetet monetare dhe ekuivalentet sipas monedhës origjinale janë detajuar si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>
Mjete monetare në bankë në euro	8,127,253
Mjete monetare në bankë në dollar	16,299
Mjete monetare në bankë në monedhë të huaj	<u>8,143,552</u>

12. AKSIONE NË SHOQËRI TË LIDHURA

Në datën 4 tetor 2019 Shoqëria ka themeluar shoqërinë aksionare Albsig-Invest. Në datën 3 tetor 2019, Asambleja e aksionerit të vetëm të shoqërisë, Albsig sh.a miratoi krijimin e shoqërisë së re Albsig Invest. Në momentin e krijimit kapitali nënshkruar i shoqërisë ishte 17,944,000 lekë i zotëruar terësisht nga Albsig Jetë sh.a.

Më datë 1 nëntor 2019, asambleja e aksionereve, vendosi rritjen e kapitalit aksionar me 14,056,000 Lek. Në datën 8 nëntor 2019 u përfundua rritja e kapitalit, në total vlera e investimit në Albsig Invest është 32,000,000 Lek. Shoqëria zotëron 100% të aksioneve.

13. KOSTO TË SHTYRA TË MARRJES NË SIGURIM

Kostot e shtyra të marrjes në sigurim sipas produkteve më 31 dhjetor 2019 janë si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>
Sigurimi i jetës:	
sigurimi i jetës së debitorit	163,776
sigurimi i jetës në grup	52,937
sigurimi sipas skemave 'cash plan'	155,557
	<u>372,270</u>

14. REZERVA PËR PRIMET E PAFITUAR

Rezerva për primet e pafitur më 31 dhjetor 2019 përbëhet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>
Sigurimi i jetës:	
sigurimi i jetës së debitorit	648,365
sigurimi i jetës në grup	257,042
sigurimi sipas skemave 'cash plan'	755,315
	<u>1,660,722</u>

Albsig Jetë sh.a
Shënime mbi Pasqyrat Financiare për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2019
(Vlerat janë në Lek)

15. DETYRIME PËR PALËT E LIDHURA

Detyrim për palët e lidhura deri më 31 dhjetor 2019 janë të detajuara si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>
Të pagueshme ndaj Albsig sh.a	19,254,940
	<u>19,254,940</u>

Shoqëria është financuar nga aksionare me qëllim të fillimit të aktivitetit.

16. DETYRIME TË TJERA

Detyrimet e tjera më 31 dhjetor 2019 janë detajuar si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>
Furnitorë	290,855
Personeli, Kontributi i Sig. Shoqërore, tatimi mbi të ardhurat	1,301,008
Kreditorë të tjerë	89,301
	<u>1,681,164</u>

17. KAPITALI I AKSIONAR

Kapitali i paguar i Shoqërisë më 31 dhjetor 2019 është 402,000 mijë Lekë përberë nga 402,000 aksione të zakonshme me vlerë nominale 1,000 Lek.

Struktura e kapitalit aksionar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2019 paraqitet si vijon:

	<u>31 dhjetor 2019</u>		
	në %	Numri i aksioneve	Në lekë
Albsig sh.a	100.00	402,000	402,000,000
Totali	100.00	402,000	402,000,000

Kapitali i nënshkruar në momentin e themelimit të shoqërisë ishte 370,000,000 Lek, në datën 1 nëntor 2019 asambleja e aksionareve të Albsig sh.a miratoi rritjen e kapitalit në masën 32,000,000 Lek. Derdhjet e kapitalit janë kryer si më poshtë:

<u>Data</u>	<u>Banka</u>	<u>Vlera</u>
29-08-19	Banka Kombëtare Tregtare	90,000,000
30-08-19	Banka e Tiranës	90,000,000
30-08-19	Banka Amerikane e Investimeve	90,000,000
30-08-19	Procredit Bank	13,000,000
30-08-19	Procredit Bank	87,000,000
05-11-19	Banka e Tiranës	19,100,000
05-11-19	Banka e Tiranës	12,900,000
Totali		402,000,000

18. PRIME TË SHKRUARA BRUTO

Primi i shkruar bruto për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2019 është detajuar si më poshtë, bazuar në kategorinë e produktit:

	<u>Për periudhën 13 shtator 2019 deri më 31 dhjetor 2019</u>
Sigurimi i jetës së debitorit	3,524,801
Sigurimi i jetës në grup	2,750,200
Sigurimi sipas skemave 'cash plan'	789,843
	<u><u>7,064,844</u></u>

19. TË ARDHURA NGA INTERESI

Të ardhurat nga interesi për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2019 sipas aktivitetit janë si më poshtë:

	<u>Për periudhën 13 shtator 2019 deri më 31 dhjetor 2019</u>
Të ardhura nga interesat e depozitave me afat	1,582,312
	<u><u>1,582,312</u></u>

20. KOSTOT E MARRJES NË SIGURIM

Kostot e marrjes në sigurim për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2019 janë detajuar si më poshtë:

	<u>Për periudhën 13 shtator 2019 deri më 31 dhjetor 2019</u>
Komisionet e agjentëve	81,500
Pagat e rrjetit të shitjes	1,455,000
Shpenzime të tjera të marrjes në sigurim	82,925
Totali	<u><u>1,619,425</u></u>

Kostot e marrjes në sigurim për çdo linjë produkti janë detajuar si më poshtë:

	<u>Për periudhën 13 shtator 2019 deri më 31 dhjetor 2019</u>
Sigurimi i jetës së debitorit	890,356
Sigurimi i jetës në grup	566,401
Sigurimi sipas skemave 'cash plan'	162,668
Totali	<u><u>1,619,425</u></u>

21. SHPENZIMET ADMINISTRATIVE

Shpenzimet administrative për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2019 janë detajuar si më poshtë:

	Për periudhën 13 shtator 2019 deri më 31 dhjetor 2019
Shpenzime personeli	2,358,007
<i>Paga</i>	<i>2,097,805</i>
<i>Kontributet e sigurimeve shoqërore</i>	<i>260,202</i>
Kontribute ndaj Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare	106,021
Honorare	450,000
Shpenzime për kancelari	20,050
Komisione bankare	34,904
Amortizim aktive afatgjata jomateriale	5,238
Taksa e tarifa vendore	27,917
Shpenzime të tjera	138,829
	3,140,966

Më 31 dhjetor 2019, Shoqëria ka patur mesatarisht 4 punonjës dhe drejtues.

Lista e detajimit të kategorisë së punonjësve është si më poshtë:

	Numri mesatar
Drejtimi	2
Mjek	1
Specialist i marrjes në sigurim	1
	4

22. TË ARDHURA/ (SHPENZIME) FINANCIARE, NETO

Shpenzimet/ të ardhurat financiare neto për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2019 janë detajuar si më poshtë:

	Për periudhën 13 shtator 2019 deri më 31 dhjetor 2019
Të ardhura nga diferenat në kursin e këmbimit	1,281,308
Humbje nga diferenat në kursin e këmbimit	(610,425)
	670,883

23. SHPENZIME TATIM FITIMI

Më poshtë kemi paraqitur rakordimin e tatim fitimit të llogaritur me normën e aplikueshme të tatimit të fitimit:

	<u>Për periudhën 13 shtator 2019 deri më 31 dhjetor 2019</u>
<i>Fitimi para tatimit</i>	3,560,162
Total shpenzime të panjohura	10,000
Penalitete, gjoba e dëmshpërblime	10,000
Shpenzime te tjera te panjohura	-
<i>Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)</i>	<u>3,570,162</u>
<i>Tatim fitimi @15%</i>	535,524
Fitimi pas tatimit	<u>3,024,638</u>
	<u>31 dhjetor 2019</u>
Gjendja në fillim	-
Pagesa gjatë vitit	-
Shpenzime të tatim fitimit	535,524
Gjendja ne fund	<u>535,524</u>

Tatimi fitimi në Shqipëri në vitin 2019 llogaritet duke aplikuar normën 15% mbi fitimin para tatimit. Shpenzimet e pazbritshme janë të gjitha shpenzimet të pa shoqëruara me dokumentacion, siç kërkohet nga ligji Shqiptar, të gjitha shpenzimet që janë të shoqëruara me dokumenta por që nuk janë të njohura nga autoritetet tatimore dhe gjoba të marra për vonesat në dokumentacion drejt Drejtorisë së Tatimeve. Këto shpenzime regjistrohen si të tilla por nuk janë të zbritshme për qëllime tatim fitimi.

24. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR

Shoqëria pranon rrezikun e sigurimit te kontratave të sigurimit kur merr përsipër rrezikun e humbjes nga personat ose organizatat që janë subjekt direkt i humbjeve të ndodhura. Shoqëria është e ekspozuar ndaj pasigurive si pasojë e kohës, frekuencës dhe pasojave të dëmeve nën këto kontrata.

Shoqëria menaxhon rrezikun e saj nëpërmjet strategjisë së nënshkrimeve dhe risigurimeve me një strukturë domethënëse të menaxhimit të rrezikut. Çmimi bazohet në supozimet të cilat kanë parasysh tendencat dhe eksperiencën e mëparshme.

Ekspozimet janë manaxhuar duke patur limite dhe kritere të dokumentuara nënshkrimesh. Risigurimi është blerë për të lehtësuar efektin e humbjeve të mundshme të shoqërisë nga përgjegjësitë individuale ose ngjarjet katastrofike dhe gjithashtu për të siguruar akses në rreziqe specifike dhe për të asistuar në kapitalin menaxhues. Politikat e risigurimit janë përcaktuar me risiguresit e aprovuar sipas ndarjes proporcionale ose të tejkalimit të humbjeve.

Albsig Jetë sh.a
Shënime mbi Pasqyrat Financiare për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2019
(Vlerat janë në Lek)

23. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

23.1. RREZIKU I NORMËS SË INTEREST

Rreziku i normave të interesit është i ndikuar nga rreziku i luhatjeve të vlerave të instrumenteve financiare si pasqje e ndryshimeve në tregun e normave të interesit dhe rreziku që maturitetet e interesave në lidhje me aktivet të ndryshojë nga maturiteti i interesave të lidhura me detyrimet e përdorura për këto aktive. Kofëzgjatja për të cilën është fiksuar norma e interesit mbi një instrument financiar tregon se ndaj çfarë niveli rreziku të normave të interesit është ekspozuar. Aktivet dhe pasivet e shoqërisë kanë norma interesi të tregut.

Shoqëria mban një shumë jo të konsiderueshme të detyrimeve interesi mbartëse dhe rreziku i shkakimit të kostove të rëndësishme që vijnë si shkak i rritjes në normat e interesit nuk është domethënëse. Në krahasim tjetër, aktivet interesi mbartëse kanë normë interesi fikse.

2019

	Norma efektive e interesit	Deri në 1 muaj	1 - 3 muaj	3 deri në 12 muaj	Mbi 12 muaj	Që nuk mbartin interes	Total
Aktive Financiare							
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to						11,384,558	11,384,558
Depozita me afat me bankat	1.08%		372,256,710				372,256,710
Totali i aktiveve financiare		-	-	372,256,710	-	11,384,558	383,641,268
Detyrime financiare							
Detyrime ndaj palëve të lidhura						19,254,940	19,254,940
Totali detyrimeve financiare		-	-	-	-	19,254,940	19,254,940
Ekspozimi							
Ekspozimi kumulativ							
		-	-	372,256,710	-	(7,870,382)	364,386,328
		-	-	372,256,710	372,256,710	364,386,328	-

23. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**23.2. RREZIKU I RISIGURIMIT**

Shoqëria çedon rrezik sigurimi në limitet e ekspozimit të humbjeve të nënshkuara nën marrëveshje të ndryshme që mbulojnë linja biznesi të përcaktuara, mbi bashkësigurimin, çdo vit me terma të rinovueshëm dhe tejkalim i bazave të humbjes. Këto marrëveshje risigurimi shpërndajnë rrezikun dhe minimizojnë efektin e humbjes. Sipas termave të marrëveshjes së risigurimit, risiguruesi bie dakord të rimbursojë shumën e çeduar në ngjarjen kur paguhet dëmi. Gjithsesi shoqëria mbetet përgjegjëse ndaj policëmbajtësve të saj duke respektuar sigurimin e çeduar nëse ndonjë risigurues dështon të plotësojë detyrimet që merr përsipër.

Kur përzgjidhet një risigurues shoqëria merr në konsideratë sigurinë e tyre relative. Siguria e risiguruesit është vlerësuar nga informacioni i normimit publik.

23.3. RREZIKU I ADMINISTRIMIT TË KAPITALIT

Strategjia e shoqërisë në lidhje me rrezikun e kapitalit nuk ka ndryshuar. Struktura kapitale e shoqërisë konsiston në kapitalin aksionar të shoqërisë që përbëhet nga kapitali themeltar, rezervat dhe fitimet e mbartura. Shoqëria menaxhon kapitalin për të siguruar nivelin e duhur të kapitalit në mënyrë që të jetë e aftë të vazhdojë në vijimësi dhe të përmbushë kërkesat rregullore të kapitalit, ndërkohë që maksimizon kthimin tek aksionaret nëpërmjet optimizimit të gjendjes së detyrimeve dhe kapitalit.

Më 31 dhjetor 2019 aksionet e kapitalit të Shoqërisë janë në përputhje me kërkesat dhe rregullat për sigurimet, për kapitalin aksionar.

23.4. RREZIQE TË TJERA

Ndryshimet legjislative në segmentet e biznesit në të cilat operon shoqëria mund të ndikojnë tek fitimet. Aktiviteti i sigurimeve është objekt i mbikëqyrjeve gjithëpërfshirëse e në zhvillim e sipër në Shqipëri. Qëllimi kryesor i legjislativit është mbrojtja e të siguruarve. Ndryshime të ligjeve mbi sigurimet mund të ndikojnë mbi aktivitetin e shoqërisë dhe të produkteve të ofruara. Ligjet mbi sigurimet dhe rregulloret e ndryshuara në kohë mund të jenë kufizuese dhe me kosto më të larta.

23.5. RREZIKU I VALUTËS

Primet janë shprehur në tre valuta kryesore (LEK, USD dhe EURO).

Tabela e mëposhtme paraqet një analizë sasiore të rrezikut valutor të shoqërisë më 31 dhjetor 2019.

	Ndikimi	2019 në Lek
EUR rritet me 10% ndaj Lekut	Fitim	9,732,911
EUR ulet me 10% ndaj Lekut	Humbje	(9,732,911)
USD rritet me 10% ndaj Lekut	Fitim	544
USD ulet me 10% ndaj Lekut	Humbje	(544)

23. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**23.6. RREZIKU I VALUTËS (VAZHDIM)**

Primet janë shprehur në tre valuta kryesore (LEK, USD dhe EURO). Flukset monetare nga të ardhurat nga primet janë burimi kryesor i fondeve për depozitat me afat në valutë të huaj.

Tabela e mëposhtme paraqet një analizë sasiore të rrezikut valutor të Shoqërisë më 31 dhjetor 2019.

	LEK	EUR	USD	Total
Aktive Financiare				
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to	3,241,006	8,127,253	16,299	11,384,558
Depozita me afat me bankat	284,405,040	87,851,670	-	372,256,710
Llogari të arkëtueshme nga aktiviteti i sigurues	811,721	1,265,886	-	2,077,607
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	2,000,000	7,373,174	-	9,373,174
Totali i aktiveve financiare	292,457,767	111,991,157	16,299	404,465,223
Detyrime Financiare				
Detyrime ndaj palëve të lidhura	4,619,499	14,624,577	10,864	19,254,940
Detyrim tatim fitimi	535,524	-	-	535,524
Detyrime të tjera	1,643,695	37,469	-	1,681,164
Totali detyrimeve financiare	6,798,718	14,662,046	10,864	21,471,628
Pozicioni valutor, neto	285,659,049	97,329,111	5,435	382,993,595

23.7. RREZIKU I MATURITETIT

Tabela më poshtë analizon aktivet dhe pasivet financiare të shoqërisë më 31 dhjetor 2019 në grupe të ngjashme maturiteti duke u bazuar në kohën e mbetur nga data e raportimit në maturitetin aktual:

2019	Deri në 1 muaj	1 - 3 muaj	3 deri në 12 muaj	Mbi 12 muaj	Total
Aktive Financiare					
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to	11,384,558				11,384,558
Depozita me afat me bankat			372,256,710		372,256,710
Llogari të arkëtueshme nga aktiviteti i sigurues	2,077,607				2,077,607
Totali i aktiveve financiare	13,462,165	-	372,256,710	-	385,718,875
Detyrime financiare					
Detyrime ndaj palëve të lidhura			19,254,940		19,254,940
Detyrim tatim fitimi		535,524			535,524
Detyrime të tjera	1,301,008	380,156			1,681,164
Totali detyrimeve financiare	1,301,008	915,680	19,254,940	-	21,471,628
Ekspozimi	12,262,995	(726,552)	353,001,770	-	364,538,213
Ekspozimi kumulativ	12,262,995	11,536,443	364,538,213	364,538,213	-

23. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**23.8. RREZIKU I KREDISË**

Rreziku i kredisë i referohet rrezikut që pala tjetër do të dështojë në përmbushjen e detyrimeve kontraktuale duke sjellë humbje financiare për Shoqërinë. Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë në depozitat me afat dhe të arkëtueshmet nga sigurimi dhe risigurimi i palës tjetër. Drejtimi beson se rreziku i kredisë i lidhur me depozitat me afat nuk është i rëndësishëm.

Shoqëria e menaxhon ekspozimin ndaj rrezikut të kredisë në baza të vazhdueshme duke monitoruar vazhdimisht të arkëtueshmet nga sigurimi dhe risigurimi.

Të arkëtueshmet neto nga sigurimi dhe risigurimi më 31 dhjetor 2019 sipas vjetërsisë së tyre janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	
	në lek	në %
1-90 ditë	2,077,607	100%
91-365 ditë	-	0%
> 365 ditë	-	0%
Totali	2,077,607	100%

24. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA

Palët konsiderohen të jenë të lidhura nëse njëra palë ka aftësinë të kontrollojë ose ushtrojë ndikim domethënës mbi pjesën tjetër për të marrë vendime financiare ose operative, ose palët janë nën kontrollin të përbashkët me Shoqërinë.

Një numër transaksionesh janë ndërmarrë me palët e lidhura gjatë aktivitetit të zakonshëm të Shoqërisë. Këto transaksione kanë ndodhur mbi terma tregtare dhe në normat e tregut. Volumi i këtyre transaksioneve dhe gjendjet pezull në fund të periudhave përkatëse janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2019
<i>Pasqyra individuale e pozicionit financiar</i>	
Të arkëtueshme nga shoqëritë e lidhura	9,373,174
Detyrime ndaj kompanive të lidhura	19,254,940

Shpërblimi i drejtimit për periudhën 13 shtator 2019 deri më 31 dhjetor 2019 ka qenë në vlerën 2,539,731 lekë.

25. ANGAZHIME DHE DETYRIME TË MUNDSHME*Çështje gjyqësore*

Në veprimtarinë e zakonshme të biznesit, Shoqëria përfshihet në çështje të ndryshme gjyqësore. Sipas opinionit të drejtimit dhe avokatit ligjor, shoqëria nuk ka dëme që kërkojnë shënime shpjeguese apo njohje të provizioneve në përputhje me SNRF-të. Shoqëria nuk ka angazhime të rëndësishme në datën e raportimit.

25. VLERËSIMI ME VLERË TË DREJTË

Drejtimi përdor vlerësimin dhe supozimet më të mira, sipas llojit të aktivitetit dhe pasivit, për të përcaktuar vlerën e drejtë të instrumenteve financiare, ku të dhënat e tregut aktiv nuk janë të disponueshme.

Vlera kontabël e instrumenteve financiare është konsideruar si një përafrim i arsyeshëm i vlerës së drejtë.

26. NGJARJE PAS BILANCIT

Më 11 Mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetit e deklaroi koronavirusin (COVID-19) një pandemi. Ndërsa situata është ende duke u zhvilluar në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Menaxhimi pret që zhvlerësimi i aktiveve, inventari, vlera e drejtë, të ndikohen nga situata. Impakti financiar do të njihet nga Kompania gjatë vitit 2020. Menaxhimi do të vazhdojë të monitorojë ndikimin e mundshëm dhe do të ndër marrë të gjitha hapat e mundshëm për të lehtësuar çdo efekt. Menaxhimi e konsideron këtë pandemi si një ngjarje që nuk rregullohet pas datës së raportimit dhe e ka shpalosur në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare. Efektet mbi bazën e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare janë shpalosur në shënimin 2 të këtyre pasqyrave financiare.

Nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme pas datës së raportimit që do të kërkojnë rregullime ose shënime shpjeguese shtesë në pasqyrat financiare individuale.

SKEDULE SUPLEMENTARE

1. AKTIVE NË MBULIM TË PROVIJONEVE TEKNIKE

Nr.	Emërtimi	% e lejuar	Vlera në fakt	% faktike	Investime mbi limitet e lejuara
I.	Aktivët e lejuara në mbulim të provigjoneve teknike, të ndryshme nga ato matematike, sipas nenit 97 të Ligjit 52/14		674,400		-
I.1	a) Tituj të emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë ose Banka e Shqipërisë	100%		0.0%	-
I.2	b) Obligacione dhe tituj të tjerë borxhi, të garantuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë	100%		0.0%	-
I.3	c) Obligacione dhe tituj të tjerë borxhi, të emetuar nga qeverisja vendore e Republikës së Shqipërisë;	10%		0.0%	-
I.4	ç) Obligacione dhe tituj të tjerë borxhi, të shoqëruara nga garanci të emetuara nga qeverisja vendore e Republikës së Shqipërisë;				
I.5	d) Obligacione dhe tituj të tjerë borxhi, të tregtuar në tregje të rregulluara në Republikën e Shqipërisë;	35%		0.0%	-
I.6	dh) Obligacione dhe tituj të tjerë borxhi, të cilët nuk tregtohen në tregje të rregulluara në Republikën e Shqipërisë, nëse emetuesi i tyre është person juridik, me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë;	5%		0.0%	-
I.7	e) Aksione të tregtuara në tregje të rregulluara në Republikën e Shqipërisë;	25%		0.0%	-
I.8	ë) Aksione, të cilat nuk tregtohen në tregje të rregulluara në Republikën e Shqipërisë, nëse emetuesi i tyre është person juridik, me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë;	5%		0.0%	-
I.9	f) Kuota/aksione të sipërmarrjeve të investimeve kolektive të regjistruara në Republikën e Shqipërisë;	40%		0.0%	-
I.10	g) Hua të pasiguruara dhe hua të siguruara nga garanci hipotekore, garanci bankare ose siguruese në Republikën e Shqipërisë, me kusht që këto të fundit të mos jenë siguruar nga shoqëri sigurimi apo banka të kontrolluara nga i njëjti grup që kontrollon dhe shoqërinë ;	10%		0.0%	-
I.11	gj) Toka, ndërtesa dhe të drejta në pasuri të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë nëse plotësohen njëkohësisht kërkesat sipas nenit 97, germa gj) e Ligjit 52/14;	30%		0.0%	-
	Qëllime shfrytëzimi				
	<i>SHEMBULL (Nr.Pasurie 1234, Volum 12, Faqe 12, Zona Kadastrale 1234, Qyteti)</i>	10%		0.0%	-
I.12	h) Depozita në banka dhe/ose degë të bankave të huaja, me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë.	100%	674,400	40.6%	-
II.	Investime të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike, të ndryshme nga ato matematike, për të cilat është marrë miratimi paraprak i Autoritetit:				
II.1	a) Obligacione afatgjata dhe tituj borxhi afatgjatë të emetuar nga një vend anëtar ose vend anëtar i OECD-së; që janë të kthasifikuar si BBB+ e më lart sipas Standart & Poor's ose vlerësimi ekuivalent nga vlerësues të tjerë ndërkombëtarë të njohur gjerësisht;	15%		0.0%	-
II.2	b) Obligacione afatgjata dhe tituj afatgjatë të emetuar nga një entitet joqeveritar i një vendi anëtar ose vendi anëtar të OECD-së; me kushtin që entitetet jo qeveritare emetuese të jenë Banka Ndërkombëtare e Pagesave (BIS), Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), Komisioni Evropian apo banka zhvillimi shumëpalëshe, nëse ato plotësojnë të gjitha kriteret e mëposhtme:				
	i) Për këta tituj ekzistojnë tregje aktive të marrëveshjeve të riblerjes;				
	ii) Titujt nuk janë emetuar nga bankat apo institucione të tjera financiare.				
II.3	Aksione të emetuara nga një shoqëri aksionare e huaj, e cila tregton në tregje të rregulluara të kapitalit në një vend anëtar ose vend anëtar të OECD-së;	15%		0.0%	-

Albsig Jetë sh.a
(Vlerat janë në Lek)

Nr.	Emërtimi	% e lejuar	Vlera në fakt	% faktike	Investime mbi limitet e lejuara
II.4	Kuota/aksione të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, të cilat tregtohen në një vend anëtar ose vend anëtar të OECD-së.				
III.	Investime të tjera të lejuara sipas Rregullores nr. 19, date 28.04.2015, nenit 4:		15,979,294		14,891,182
III.1	b) Kredi individuale hipotekore për apartamente banimi vetëm për punonjësit e shoqërisë së sigurimit;	1%		0.0%	-
III.2	c) Para dhe ekuivalentë të saj (të cilat përfaqësojnë mjete monetare në arkë, mjete monetare në bankë dhe depozita me afat maturimi më të vogël se 3 muaj), në banka të licencuara nga Banka e Shqipërisë, me seli në Republikën e Shqipërisë;	3%	11,384,558	685.5%	11,334,736
III.3	c) Të arkëtueshmet nga risiguresit, që nuk janë pezull më shumë se 90 ditë nga lindja e detyrimit;	25%		17.5%	-
III.4	d) Pjesën e risiguresit në provigjonet teknike, kur risiguresit janë të klasifikuar si BBB- e më poshtë nga Standart & Poor;		290,966		
III.5	d) Pjesën e risiguresit në provigjonet teknike, kur risiguresit janë të klasifikuar si BBB- e më lart nga Standart & Poor;	100%		0.0%	-
III.6	e) Depozita në shoqëri ceduese dhe borxhe të zotëruara nga ato;	20%		0.0%	-
III.7	f) Shuma, që detyrohen nga policëmbajtësit dhe ndërmjetësit, e që rrjedhin nga veprimtaria e sigurimeve të drejtpërdrejta dhe risiguresese, n.q.s nga dita e detyrimit të pagesës nuk kanë kaluar më shumë se 90 ditë, por jo më shumë se 20 % e provigjontit të primit të pafitur;	20%	2,077,607	125.1%	1,745,463
III.8	g) Aktive të qëndrueshme të trupëzuara, përveç atyre të parashikuara në shkronjën "gj", pika 1. të nenit 97, të ligjit nr. 52, datë 22.05.2014, "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit".	5%	271,583	16.4%	188,547
III.9	h) Interesa dhe qera të maturuara dhe të ardhura të tjera të maturuara.	5%	1,582,310	95.3%	1,499,274
III.10	i) Investimet në depozitat e garancisë së Kartonit jeshil pranë BSHS	100%		0.0%	-
III.11	j) Shpenzimet e marrjes në sigurim të shtyra	15%	372,270	22.4%	123,162
IV	TOTALI I INVESTIMEVE (I+II+III)		16,653,694		14,891,182
V	TOTALI I INVESTIMEVE TE LEJUARA (Totali i "Vlera në fakt" zbritur "Investime mbi limitet e lejuara")		1,762,513		
VI	C. Provigjone teknike, të ndryshme nga ato matematike, bruto (VI.1 deri VI.5)		1,660,722		
VI.1	<i>Provigjone të primit të pafitur</i>		<i>1,660,722</i>		
VI.2	<i>Provigjone të dëmeve</i>				
VI.3	<i>Provigjone për bonuse dhe rabate</i>				
VI.4	<i>Provigjone barazimi dhe katastrofe</i>				
VI.5	<i>Provigjone të tjera teknike</i>				
VII	Tepriçë (+) / Mungesë(-) (V-VI)		101,791		
VIII	Mbulimi në % (V/VI)		106.13%		

2. RAPORT MBI MJAFTUESHMËRINË E KAPITALIT

Nr.	Emërtimi	Vlera në lekë
I	Kapitali bazë, Neni 76 i Ligjit 52/14 (I.a+I.b+I.c-II)	404,904,518
I.a	Kapitali aksionar i shoqërisë së sigurimit, i cili përbëhet nga aksionet e zakonshme të emetuara;	402,000,000
I.b	Rezervat e kapitalit, të cilat nuk i korrespondojnë detyrimeve që rrjedhin nga kontratat e sigurimit;	
I.c	Fitim i pashpërndarë, i mbartur pas zbritjes së dividendëve të pagueshëm	3,024,638
II	Elementet që nuk përfshihen në llogaritjen e kapitalit bazë: (II.a+II.b+II.c+II.ç)	120,120
II.a	Aksionet e veta të riblera	
II.b	Investimet në aktive të patrupëzuara	120,120
II.c	Humbjet e mbartura dhe humbja e vilit ushtrimor	
II.ç	Diferenca midis provigjoneve të dëmeve të skontuara dhe të paskontuara.	
III	Kapitali shtesë, neni 77 i Ligjit 52/14 (III.a+III.b+III.c+III.ç)	0
III.a	Kapitali aksionar i cili përbëhet nga aksionet me përparësi të akumuluar	
III.b	Instrumente të borxhit të varur	
III.c	Rezerva kapitali që lidhen me aksionet me përparësi të akumuluar	
III.ç	Elemente të tjera	
IV	Elementet e zbritshme në llogaritjen e kapitalit, neni 79 i Ligjit 52/14 (IV.a+IV.b+IV.c+V)	41,383,174
IV.a	Pjesëmarrje dhe instrumente të borxhit të varur në një tjetër shoqëri siguri, risigurimi, grupi kontrollues sigurimi, banka dhe/ose degë të bankave të huaja, shoqëri komisionere, shoqëri administruese dhe institucione të tjera financiare, në të cilat shoqëria e sigurimit zotëron pjesëmarrje influencuese mbi 10 për qind	32,000,000
IV.b	Investime të tjera në personat e parashikuar në shkronjën "a", të kësaj pike, që janë përfshirë në llogaritjen e kapitalit të personave përkatës	
IV.c	Pjesëmarrjet dhe titujt e borxhit të varur, si dhe investime të tjera në një shoqëri tjetër siguri ose ente financiare, të tjera nga ato të parashikuara në shkronjën "a", të kësaj pike, të cilat kalojnë masën 10 për qind të kapitalit të shoqërisë së sigurimit, e llogaritur përpara zbritjes së elementeve të përmendura në shkronjat "a" dhe "b" të kësaj pike	
V	Aktivët jotikuide (V.a deri V.g)	9,383,174
V.a	Aksionet e palistuar në tregje të rregulluara	
V.b	Huatë/llogaritë e arkëtueshme me palë të lidhura	
V.c	Huatë nga brokerat dhe agjentët	
V.ç	Primet e arkëtueshme ose debitorë nga risigurimi, që kanë tejkaluar afatin 90- ditor;	
V.d	Debitorë të tjerë ose llogari të tjera të arkëtueshme, të cilat nuk rrjedhin drejtpërsëdrejti nga veprimtaria e sigurimit;	9,373,174
V.dh	Inventari	10,000
V.e	Shpenzimet e shtyra të marrjes në siguri	
V.ë	Shpenzimet e parapaguara	
V.f	Aktivët e tjera, të cilat nuk janë të lira nga çdo përgjegjësi apo detyrim i parashikuar	
V.g	Aktivët e tjera, të cilat nuk janë lehtësisht të kthyeshme në para në momentin kur është e nevojshme përmbushja e detyrimeve financiare kur u vjen afati	
V.h	Elementë të tjerë të zbritshëm sipas nenit 4 të kësaj rregullore (V.-h-1 deri V.h-10);	0
V.h-1	<i>Emri i mirë i shoqërisë</i>	
V.h-2	<i>Toka, ndërtesa dhe të drejta në pasuri të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë nëse nuk plotësohen njëkohësisht kërkesat sipas nenit 4, pika 1, germa c) të rregullores</i>	
V.h-3	<i>Aktive afatgjata materiale për të cilat shoqëria nuk zotëron dokumentacionin mbi pronësinë;</i>	

Albsig Jetë sh.a
(Vlerat janë në Lek)

Nr.	Emërtimi	Vlera në lekë
V.h-4	<i>Aktive afatgjata materiale që vijnë nga shpenzime për përmirësimin e ambienteve me qira</i>	
V.h-5	<i>Aktive afatgjata materiale në formën e materialeve publicitare</i>	
V.h-6	<i>Likuiditete në Banka, në rast se shoqëria ka një linjë kredie të hapur në llogari rrjedhëse (overdraft) apo të ngjashme, në vlerën maksimale të kredisë së hapur në llogari rrjedhëse (overdraft) apo të ngjashme;</i>	
V.h-7	<i>Të ardhura të llogaritura nga paditë e regresit nga Fondi i Kompensimit apo të tjera në rast se shoqëria nuk zotëron dokumentacion justifikues të mjaftueshëm për të garantuar arkëtimin e shumës</i>	
V.h-8	<i>Të gjitha aktivet e lëna si kolateral, të lënë peng apo që nuk janë të lira nga çdo barrë tjetër në të gjithë vlerën e tyre</i>	
V.h-9	<i>Fondi i Garancisë për Kartonin Jeshil</i>	
V.h-10	<i>Çdo zë tjetër në kundërshtim me kërkesat ligjore, rregulatore dhe vendime të Bordit të Autoritetit</i>	
VI	KAPITALI (Aftësia Paguese)	363,521,344
VII	Kufiri minimal i aftësisë paguese, sipas pikës 3 të nenit 80 të Ligjit Nr. 52/2014	0
VIII	Fondi i garancisë, sipas nenit 81 të Ligjit Nr. 52/2014	370,000,000
IX	Niveli i kërkuar i aftësisë paguese, sipas pikës 2 të nenit 80 të Ligjit Nr. 52/2014	370,000,000
X	Mbi (+) / nën (-) nivelin e kërkuar të Aftësisë paguese (VI-IX)	(6,478,656)
XI	Mjaftueshmëria e kapitalit	I pamjaftueshëm